KQZ
U PROTOKOLLUA
NR. 4947 PROT
DATE 6.5.2021

**Shtojca nr. 3**
**Raport Përfundimtar i Monitoruesve**

## I. Përmbledhje

| | |
|---|---|
| **Vëzhguesi:** (Emri, mbiemri) | |
| **Rajoni/ Njësia administrative e monitoruar:** | **Qarku Korce, Bashkia Pogradec, Njesia Administrative Bucimas, Cerrave, Dardhas, Proptisht, Udenisht, Velcan.** |
| **Subjektet Zgjedhore të monitoruar:** | **Partia Socialiste(PS),Partia Demokratike(PD), Partia Levizja Socialiste per Integrim(LSI), Partia Social Demokrate(PSD), Partia Drejtesi Integrim dhe Unitet (PDIU).** |
| **Periudha e mbuluar nga raporti:** | **06.03.2021-26.04.2021** |
| **Data e dorëzimit të raportit:** | **05.05.2021** |
| **Nënshkrimi** | |

Shënim: për Seksionin II (monitorimi i aktiviteteve të fushatës), një raport monitorimi i veçantë duhet të plotësohet për secilin subjekt zgjedhor, duke përdorur formularin e dhënë. Për seksionin III (monitorimi i abuzimeve/ keqpërdorimeve të burimeve shtetërore), një raport duhet të plotësohet për të gjithë zonën gjeografike të monitoruar.

## II. Subjekti Zgjedhor – AKTIVITETET E MONITORUARA TË FUSHATËS

Një raport monitorimi i veçantë duhet të plotësohet për secilin subjekt zgjedhor, duke përdorur formularin e mëposhtëm.

| |
|---|
| Raporti i Monitorimit për Subjektin Zgjedhor: **PS,PD,LSI,PSD,PDIU.** |

**1. Përmbledhja e aktiviteteve të monitoruara të subjektit zgjedhor**

| **Lloji i aktivitetit të monitoruar** | **Detaje** |
|---|---|
| a) Zyrat Zgjedhore | Vendndodhja e zyrave zgjedhore të monitoruara<br><br>**Gjetje: Gjate monitorimit te fushates zgjedhore te partise Socialiste(PS) u konstatuan 6 zyra zgjedhore ne qytetin e Pogradecit.**<br><br>**Gjate monitorimit te fushates zgjedhore te partise Demokratike(PD) u konstatuan 5 zyra zgjedhore ne qytetin e Pogradecit.**<br><br>**Gjate monitorimit te fushates zgjedhore per partine Levizja Socialiste per Integrim(LSI) u konstatua vetem nje zyre zgjedhore. Kjo zyre zgjedhore ndodhet ne ambientet e administruara** |

**nga bashkia Pogradec. Nga biseda qe kam patur me kandidatin per deputet te kesaj force politike Z.Gentjan Cala, me ka vene ne dijeni se per shkak te situates te krijuar nga pandemia nuk u hap asnje zyre zgjedhore ne terren.**

**Per sa i perket subjektit zgjedhor(PSD) dhe (PDIU) gjate gjithe monitorimit te fushates zgjedhore nuk u konstatua asnje zyre zgjedhore per keto dy subjekte.**

b) Ngjarjet e Fushatës

Numri i plotë i ngjarjeve të monitoruara të fushatës të mbajtura nga E/s që CM monitoroi

**Gjetje: Gjate monitorimit te fushates zgjedhore per subjektin zgjedhor (PS), kandidatet per deputet te ketij subjekti kane zhvilluar takime te ndryshme me banore te qytetit te Pogradecit dhe banoret e njesive admimistrative te ketij qyteti. Po ashtu jane zhvilluar dhe takime nga kandidatet me bizneset e qytetit. Takimet ne pergjithesi jane zhvilluar ne ambjente te hapura dhe takime dere me dere me qytetaret, por ka patur dhe takime ne zyrat zgjedhore te partise Socialiste.**

**Gjate monitorimit te fushates zgjedhore te partise Demokratike(PD) dhe partise Levizja Socialiste per Integrim(LSI), kandidatet per deputet te ketyre dy partive kane zhvilluar takime te ndryshme me banoret e rrethit te Pogradecit ku jane verejtur me shume takimet ne ambjente te hapura si dhe takime te drejtperdrejta me kalimtare ne lagjet te ndryshme te qytetit.**

**Per shkak edhe te situates te shkaktuar nga Covid-19 kandidatet e ketyre subjekteve zgjedhore(PS),(PD),(LSI),jane munduar te shmangin grumbullimet me shume persona ne ambjente te mbyllura.**

c) Materialet propagandistike

Numri i plotë materialeve propagandistike të monitoruara (të bashkangjiten mostra/foto për secilen)

**Gjetje: Gjate monitorimit te fushates zgjedhore te partise Socialiste(PS) ne takimet e kandidateve jane verejtur perdorimi i bluzave T-shirt, me logon e partise si dhe maska te personalizuara po me logon e kesaj partie te cilat jane perdorur gjate fushates.**

**Gjate monitorimit te fushates zgjedhore per partine Demokratike(PD),ne takimet e ndryshme te zhvilluara nga kandidati jane perdorur kapele me logon e kesaj partie si dhe bluzat T-shirt te personalizuara te perdorura gjate fushates.**

Numri i plotë i materialeve vizive propagandistike të shqyrtuara për përfshirjen e shënimit: 'Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të ...'

d) Monitorimi i Faqeve te internetit

Listë gjithëpërfshirëse e platformave të faqeve të internetit të monitoruara

**Gjetje: Jane monitoruar faqet Insagram dhe Facebook te subjekteve zgjedhore.**

**2. Parregullsitë e vëzhguara**

| **Neni** | **Parregullsia** | **Numri i parregullsive të raportuara në KQZ dhe datat e tyre** |
|---|---|---|
| Neni 78, pika 6 | Fushata zgjedhore në një institucion publik | **Jo** |

| | | |
|---|---|---|
| Neni 78, pika 7 | Subjektet zgjedhore/kandidatët i ofrojnë ose japin para, të mira materiale, premtojnë vende pune ose favore të tjera, votuesve ose personave të tjerë që kanë lidhje me të, me qëllimin marrjen e nënshkrimit për emërimin e një kandidati për zgjedhje, për të votuar në një mënyrë të caktuar, për të marrë pjesë ose jo në votim, ose në këmbim të angazhimit në aktivitete jo ligjore për të mbështetur një kandidat ose një parti politike. | **Jo** |
| Neni 78, pika 9 | Subjekti zgjedhor/Kandidati që organizon, bën ose mbulon shpenzimet për koncert, ngjarje kulturore dhe zbavitëse ose aktivitete bamirësie. | **Jo** |
| Neni 78, pika 10 | Subjekti zgjedhor/Kandidati që ofron sende ose materiale të printuara me vlerë prej më shumë se 5 (pesë) qind Lekë për send ose material. | **Subjektit zgjedhor (PS) dhe (PD) ju kam cuar nje kerkese informacioni me shkrim ku ju kam kerkuar burimin financiar qe kishte mundesuar vendosjen e materialeve propagandistike ne vendet e reklamave te administruara nga Bashkia Pogradec. Nuk kam marre pergjigje.** |
| Neni 79, pika 2 | Paraqitja e materialeve propagandistike statike më shumë se 5 metra nga zyra elektorale | **Jo** |
| Neni 3,paragrafi 2, Udhëzim nr. 6 datë 23.03.2021, i KQZ-së | Materiale propagandistike të vendosura në fasadat e godinave të banimit, institucione publike ose ambiente rrethuese pranë e rreth tyre, brenda zonave rekreative,parqeve, në pemët e qytetit dhe në shtyllat e ndriçimit. | **Eshte konstatuar si shkelje ne dt.26.03.2021, ku subjektet zgjedhore(PS),(PD),(LSI),(PAA), kane patur te afishuara ne fasadat e godines te bashkise Pogradec materiale propagandistike.** |
| Neni 3, paragrafi 3, Udhëzim nr. 6 datë 23.03.2021, i KQZ-së | Materiale propagandistike të vendosura në mjete që operojnë në transportin publik. | **Jo** |

| | | |
|---|---|---|
| Neni 5, Udhëzim nr. 6 datë 23.03.2021, i KQZ-së | Zyrat Zgjedhore të subjekteve zgjedhore janë hapur në distancë më të vogël se 300 metra nga vendndodhja e KZAZ-ve, QV-ve dhe VNV-ve. | **Jo** |
| Neni 79, pika 3 | Mos përfshirja e deklaratës së autorizimit në materialet vizive të fushatës propagandistike | **Jo** |

## I. <u>Raport mbi monitorimin e abuzimeve ndaj burimeve shtetërore</u>

Ky raport monitorimi plotësohet për të gjithë zonën e monitoruar, duke përdorur formularin e mëposhtëm:

### 1. Përmbledhje e Aktiviteteve të Monitoruara

| **Lloji i aktivitetit të monitoruar** | **Detaje** |
|---|---|
| a) Monitorimi i Faqeve te Internetit | Listë gjithëpërfshirëse e platformave të faqeve të internetit të monitoruara |
| b) Përdorimi i burimeve shtetërore | Numri i plotë dhe identifikimi i aktiviteteve/ngjarjeve të fushatës të monitoruara për përdorim të mundshëm të nëpunësve të administratës gjatë orarit të punës. |
| | Numri i plotë dhe identifikimi i aktiviteteve/ngjarjeve të fushatës të monitoruara për përdorim të mundshëm të studentëve para-universitar brenda orarit të mësimit. |
| | Numri i plotë/Identifikimi i institucioneve publike mjediset e të cilëve u monitoruan për të parë nëse po përdoreshin për aktivitete të fushatës. |

| | |
|---|---|
| | Numri i plotë i vëzhgimeve të bëra për përdorimin e automjeteve publike të vëzhguara në ngjarjet e fushatës. |
| c) Aktivitete të natyrës publike | Numri i plotë i aktiviteteve të monitoruara të një natyre publike të cilat kërkojnë njoftimin/raportimin tek KQZ-ja. |

**2. Abuzimi i burimeve shtetërore- Parregullsitë e vëzhguara**

| Neni | Parregullsia | Numri i plotë i parregullsive të vëzhguara dhe data në të cilën cdo parregullsi u raportua në KQZ |
|---|---|---|
| Neni 91, pika 2 | Përdorimi i detyruar në fushatën zgjedhore të administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore. | Jo |
| Neni 91, pika 2 | Përdorim i detyruar dhe organizuar brenda orarit të mësimit të studentëve të sistemit shkollor para-universitar në fushatën zgjedhore. | Jo |
| Neni 91, pika 2 | Premtimi ose ofrimi i përfitimeve punonjësve, ose studentëve për të marrë pjesë në aktivitete që lidhen me fushatën jashtë orarit të punës ose shkollës ose të ushtruarit e presionit mbi to për këtë qëllim. | Jo |
| Neni 91, pika 3 | Punësimi, pushimi nga puna, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucione ose ente publike gjatë fushatës zgjedhore, përveç rasteve të justifikuara. | **Te gjitha rastet e emerimeve dhe pushimit nga puna te bera nga bashkia Pogradec per periudhen Janar-Prill 2021 kane qene te justifikuara sipas tyre. Pergjigjen e kam marre me shkrim nga institucioni, pasi dhe kerkesa e informacionit nga ana ime drejtuar bashkise eshte bere me shkrim.** |
| Neni 92, pika 1, e 6 | Mos raportimi i aktiviteteve të natyrës publike të kryer nga institucione publike vendore dhe qëndrore, si dhe agjensi shtetërore dhe/ose ndërmarrje. | Jo |

| | | |
|---|---|---|
| Neni 91, pika 5 | Kryerja e aktiviteteve të ndaluara nga KQZ-ja. | **Jo** |

Dt.24.04.2021

Lenda: Kerkese informacioni

Unë i nënshkruari Odise Kotka në cilësinë e monitoruesit gjatë fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e kuvendit të Shqipërisë dt.25.04.2021, kërkoj nga partia që ju përfaqësoni informacion për materialet propagandistike të vendosura në zonat e caktuara nga Bashkia Pogradec. Se është respektuar apo [illegible] e këtyre zonave nga bashkia, si dhe kush është [illegible] që i ka mundësuar këto materiale propagandistike të vendosura në zona të ndryshme të qytetit. Duke ju falenderuar për bashkëpunimin dhe duke ju uruar punë të mbarë.

Faleminderit.

Monitorues qarku Korce (KQZ)

Odise Kotka